

## **PROGRAM I PROVIMIT TE FORMIMIT PROFESIONAL PËR STUDENTET BACHELOR NË HORTIKULTURË**

Objekti i PEMETARISE si shkencë dhe teknologji. Rëndësia ekonomike e pemëve frutore për ekonominë Shqiptare, problemet dhe perspektiva e kultivimit të tyre. Morfologjia dhe anatomia e organeve të pemëve; Mjedisi i kultivimit të pemëve frutore; kushtet tokësore, temperatura, drita, lagështia.

Biologjia e lulëzimit dhe frutifikimit, diferencimi i sythave frutor, lulëzimi, pjalmimi, pllenimi, pajtueshmëria dhe mos pajtueshmëria, rritja dhe zhvillimi i frutave.

Shtimi i pemëve frutore; nënshartesat, metodat e shtimit, bazat teorike të shartimit. Kriteret e krijimit dhe menaxhimit të fidanishtes frutore. Krijimi i pemëtoreve të reja, kriteret e zgjedhjes së species, kultivarit dhe distancave të mbjelljes. Teknologjia e kultivimit; punimi dhe mos punimi i tokës, ujitja, plehërimi, krasitja formuese dhe prodhuese.

POMOLOGJIA: Speciet kryesore farorë, bërthamor, gujador, manor, fiku, aktinidia, agrumet, rëndësia, përhapja, biologjia e fiziologjia, fenofazat, kërkesat specifike për tokë, ujë, gëlqere. Teknikat e zakonshme dhe moderne të kultivimit, plehërimit, mbjelljes, pjalmuesit bazë, ndikimi në cilësinë e frutave. Format dhe distancat e mbjelljes, format e ulëta dhe të larta të kurorave, sistemet mbështetës, bilancet ushqimor dhe të ujitjes, krasitja, rrallimi i frutave me dorë dhe preparate, kimike, bilanci i degëzave dhe frutave, masa gjethore, vjelja, seleksionimi, ambalazhimi, përpunimi, tregtimi i frutave.

Historia dhe perspektiva e zhvillimit të VRESHTARISE. Kërkesat e hardhisë ndaj mjedisit. Mënyrat e shumimit, etapat e prodhimit të fidanëve. Kriteret e ngritjes së vreshtave të reja. Krijimi i vreshtave mëmë, shërbimet teknologjike që kryhen.

Menaxhimi i tokës, tëharrjet (krasitjet e gjelbra), ujitja dhe plehërimi. Format dhe sistemet e mbajtjes. Koha dhe metodat e vjeljes së rrushit.

Rëndësia, përhapja, vlerat ushqyese, tendencat e prodhimit dhe konsumit të PERIMEVE. Klasifikimi i perimeve. Kërkesat e perimeve ndaj faktorëve klimatike e tokësorë. Tipet e perimtarisë. Teknikat dhe planet kulturele në perimtarinë, plehërimi, ujitja, qarkullimi, mulcimi, etj.

Trajtimi i specieve kryesore perimore për prodhimin nga fusha me destinacion konsumi i freskët: perimet frutore, perimet gjethore, perimet frutrrënjore, perimet bulbore etj. Për secilën nga këto specie do të trajtohen aspektet bazë si më poshtë: origjina, rëndësia, përhapja dhe perspektiva e zhvillimit; karakteristikat botanike dhe biologjike; ekofiziologjia (kërkesat klimatike, pedologjike dhe ushqyese); teknika kulturele (mbjellja, trapiantimi, administrimi i teknikave kulturele); pjekja, vjelja, ruajtja pas vjeljes dhe përdorimi; vlerësimi cilësor i prodhimit etj.

Rëndësia, historiku, përhapja, gjendja dhe perspektiva e zhvillimit të MJEDISEVE TE MBROJTURA. Klasifikimi i mjediseve të mbrojtura. Parime të përgjithshme konstruktive dhe ndërtimore të mjediseve të mbrojtura. Mikroklima e mjediseve të mbrojtura. Bilanci termik i mjediseve të mbrojtura. Aspekte të fiziologjisë së bimëve në mjedis të mbrojtura. Marrëdhëniet e fotosintezës dhe frymëmarrjes me temperaturën, intensitetin e ndriçimit, përqendrimin e CO<sub>2</sub>, etj. Nevojat për ujë në mjedis të mbrojtura dhe përlllogaritja e tyre. Të ushqyerit e bimëve në mjedis të mbrojtura. Roli fiziologjik i elementëve kryesorë ushqyes. Simptomat e mungesës dhe të tepicës së elementëve kryesorë ushqyes. Përlllogaritja e nevojave për plehërim. Kultivimi i domates, specit, patëllxhanit, kastravecit, pjeprit, etj në mjedis të mbrojtura.

Objekti i LULETARISE, roli i bimëve dekorative. Klasifikimi i bimëve dekorative sipas jetëgjatësisë dhe vendit të kultivimit. Shumimi i bimëve dekorative. Komponentët e përzierjes së vazos. Cilësitë dhe mënyra e përdorimit të tyre. Shërbimet kryesore agroteknike tek bimët zbukurose. Teknologjia e kultivimit të tulpanit dhe zymbylit. Kultivimi i krizantemave, trëndafilave dhe luleborës. Pemët dhe shkurret dekorative. Teknologjia e kultivimit të bimëve të larta shumëvjeçare (konifere dhe gjetherënëse).

Roli i MJEDISEVE TE GJELBERUARA. Historia e kopshteve dhe e peizazhit të projektuar; Kopshtet e lashtësisë, kopshtet e rilindjes europiane, kopshtet angleze dhe japoneze. Historia e gjelbërimit në Shqipëri. Elementet dhe parimet baze të projektimit të kopshteve. Ndërtimi i një plani për kopshtin,

zgjehja e stilit, metoda formale dhe jo formale; kopshtet mesdhetare, kopshtet japoneze, kopshtet moderne dhe kopshtet e qëndrueshme. Elementët dhe strukturat e kopshtit; Trualli ose dysHEMEJA e kopshtit, lëndinat, pjesët e shtruara, rrugicat, krijimi i kufizimeve (bordurat dhe muret), elementët e ujit. Shtretërit: planifikimi dhe mbjellja e tyre me bimë zBUKURUESE.